



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 20.01.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014" Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se:

- 1. A ka marrë Bashkia Durrës në administrim, menaxhim apo mirëmbajtje hidrovoret që shërbejnë për kullimin e ujërave në territorin e bashkisë? Nëse po, që prej cilës periudhë?**

Hidrovari i vjetër është marrë në administrim nga Bashkia sipas VKM nr. 1108 të datës 30.12.2015 për "Transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Bashkive, Të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të Personelit dhe të Aseteve Të Luajtshme e të Paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit". Ndërsa Hidrovari i ri është ende në proces testimi.

- 2. Cili është qëndrimi zyrtar i Bashkisë Durrës lidhur me pretendimet se hidrovari nuk ka lidhje funksionale me dy kanalet kryesore të kullimit në zonë?**

Të dy Hidrovoret komunikojnë me të njëjtin kanal.

- 3: Çfarë masash konkrete ka marrë Bashkia Durrës për menaxhimin e situatës së përmytjeve të ndodhura së fundmi në qytet?**

Masat konkrete të ndërmarra janë:

- Pastrimi i kanaleve kulluese të hapura
- Mirëmbajtja dhe monitorimi i Hidrovorit.

4: Cilat kanë qenë masat paraprake të ndërmarra nga Bashkia Durrës për të parandaluar përmbytjet, përpara reshjeve intensive?

Nga ana jonë është kryer pastrimi i të gjithë kanaleve kulluese kryesore që lidhen me kanalin kryesor të Hidrovorit. Më poshtë po ju listojmë dhe kanalet me kodet përkatëse sipas Inventarit tonë.

Kodi Kanalit	Lokacioni
KK-191	Shkozet, Plazh
K-192	Shkozet, Plazh
KK-19	Shkozet, Ura e Dajlanit
KK-20	Ish Nish Goma deri tek Thertorja
KK-18	Nga Royal Gaz deri tek nenkalimi i Nishtulles
KK-15	Kanali nga rruga “Azem Hajdari” deri tek impianti i pastrimit te ujrave
KK-13-14	Tek banesat e reja pas termetit
KK-14	Tek Kolektori
KK-11-12	11-pjesa e Spitalles, derdhet ne Kolektor; 12- lidhet me Shen Vlashin
KK-9	Kullon nga Spitalla ne Kolektor
KK-10	Gjysma nga autostrada ne Kolektor (gjysma tjeter i perket parkut fotovoltaik)
KK-3	Porto Romano ne Kolektor Kryesor
K1-2	Nga gjysma e sektorit Rinia (pjesa perendimore) deri te Kolektori i Hidrovorit te ri